



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 86, datë 30.03.2021

MBI

HEQJEN E LICENCËS NR. 63, SERIA NPM08P, DHËNË SHOQËRISË “ALBANIAN GREEN ENERGY” SH.P.K., ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 89, DATË 06.08.2008, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16 dhe 42, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 7, 8 dhe 9, të Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.04.2017; nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 30.03.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 39/3 prot., datë 24.03.2021 të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 36, datë 04.02.2021, vendosi:
 - *Mospranimin e kërkesës së shoqërisë “ALBANIAN GREEN ENERGY” sh.p.k., për zgjatjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 89, datë 06.08.2008, i ndryshuar.*
 - *Fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “ALBANIAN GREEN ENERGY” sh.p.k., nr. 63, seria NPM08P.*
 - *Shoqëria “ALBANIAN GREEN ENERGY” sh.p.k. ka të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.*
- Shoqëria është njoftuar për këtë vendimarrje të bordit nëpërmjet shkresës nr. 51/3 prot., datë 11.02.2021, nëpërmjet së cilës është informuar se ka 30 ditë kohë për të paraqitur argumentet e saj të mundshme me shkrim nga marrja e kësaj shkrese.
- Nuk rezulton që shkresa e dërguar të jetë kthyer mbrapsht nga posta, ndaj konsiderohet se shoqëria ka marrë dijeni për vendimarrjen e bordit të ERE-s.
- Pas përfundimit të afatit të përcaktuar prej 30 ditësh nga marrja dijeni, shoqëria “ALBANIAN GREEN ENERGY” sh.p.k., nuk ka depozituar në ERE as informacion dhe as dokumentacion

dhe nuk ka marrë masa për të shmangur shkakun ligjor që çoi ERE-n në fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 9, germa “c”, të *Rregullores për procedurat e heqjes së licensave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.04.2017, parashikohet se:

Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas nenit 7 dhe 8, të kësaj rregulloreje, bordi do të vendosë për:

c) të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat "a", "b", "c", "ç" dhe / ose "d" të nenit 5, të kësaj rregulloreje në bazë të propozimit të paraqitur në raport, në përputhje me nenin 8, të kësaj rregulloreje.

- Me heqjen e kësaj licence, shoqëria “ALBANIAN GREEN ENERGY” sh.p.k., nuk mban më statusin e të licencuarit nga ERE, licenca bëhet e pavlefshme dhe ajo nuk mund të ushtrojë më veprimtarinë për të cilën ishte licencuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të heqë licencën nr. 63, seria NPM08, dhënë shoqërisë “ALBANIAN GREEN ENERGY” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s nr. 89, datë 06.08.2008, i ndryshuar.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar bëhet e pavlefshme.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “ALBANIAN GREEN ENERGY” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe operatorët e rrjetit (Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a. dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë sh.a.), për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI